



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/ The Disciplinary Comitee

DPL.nr.08/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevc i dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në i dyshuar për shkelje disiplinore lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P. Nr. 1237/2021, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija-Kërveshi, dhe , të dy të përfaqësuar nga avokat në Prishtinë si dhe Petrit Reçica, Udhëheqës i Divizionit, për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Profesioneve të Lira, me datën 19.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si i pabazuar Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-163/2015 i datës 23.02.2022, ndërsa ankesa e paraqitur nga ana e palët ankuese dhe , e datës 22.02.2022, shpallet e papranueshme.

II. Organi përmbaues - Përmbauesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra, në lëndën përmbaimore P. Nr. 163/2015.

A r s y e t i m

Palët ankuese si në ankesë ashtu edhe në seancën dëgjimore, përmes përfaqësuesit të tyre, pretendojnë se organi përmbaues ka bërë shkelje disiplinore pasi që nuk është duke e zbatuar përmbaimin e i cili nuk e ka asnjë pengesë ligjore. I kanë propozuar komisionit disiplinor që të ndërmerren veprimet e nevojshme ndaj organit përmbaues.

Me datën 11.03.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj organit përmbaues, lidhur me mosndërmarrjen e veprimeve përmbaimore të rastit lëndor.

Përmbauesi privat në seancën e mbajtur me dt.19.05.2022 e ka kundërshtuar në tërësi si raportin e ministrisë së drejtësisë ashtu edhe pretendimet e palëve ankuese, duke pretenduar që asnjë dispozitë ligjore nuk është shkelur në rastin konkret . Poashtu ka shtuar se nga organi përmbaues madje as në raport , ministria e drejtësisë nuk e ka theksuar ndonjë dispozitë ligjore e cila është shkelur nga organi përmbaues. Më tutje ka theksuar se lënda është në proces dhe më këtë rast organi përmbaues ka ndërmarrë veprime ku edhe një pjesë e kësaj çështje veç ka përfunduar me realizimin e mjeteve financiare në llogarinë e palëve ankuese, ndërsa pjesa tjetër e kësaj çështje është në proces e sipër

I ka propozuar komisionit disiplinor që të refuzohet si raporti i ministrisë së drejtësisë ashtu edhe ankesa e palëve ankuese si të pabazuara.

Me datën 19.05.2022, Komisioni Disiplinor, pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtuqë erdhi në përfundim që organi përmbaues në këtë rast, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor i vlerësoi edhe pretendimet e palëve ankuese se deri në këtë fazë të procedurës organi përmbaues nuk ka ndërmarrë veprime për t'a përmbauar edhe pjesën tjetër të

përmbarrimit lidhur me rastin lëndor , por gjeti se kjo nuk paraqet shkelje disiplinore , meqenëse kjo çështje është në proces të përmbarrimit pas edhe plotësimit të ekspertizës financiare lëndore. As raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lirë - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, dhe as pretendimet e palëve ankuese nuk ishin bindëse se organi përmbarrues ka bërë ndonjë shkelje disiplinore ku në mënyrë taksative janë të përcaktuara shkeljet disiplinore për përmbarruesit privat në bazë të nenit 367, paragrafi 1, nën paragrafët nga 1 deri 11 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore (LPP). Për këto arsye dhe në mungesë të provave, komisioni disiplinor nuk ka gjetur asnjë arsye për të vendosur ndryshe në këtë rast.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni Disiplinor bazuar në nenin 370, paragrafi 1, lidhur me nenin 374 të Ligjit për Procedurën përmbarrimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARRUESIT PRIVAT

DPL.nr 08/2022, datë 19.05.2022



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 , par 5 të LPP-së, brenda 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi.